- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës ose ftesën për tender*].

---

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

**Shtojca 8**

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.**

**Nëçdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Në rastet e grupeve ekonomike të operatorëve ofertues referuar Neni 14 pika 2 te Ligjit 162/2020 ku citohet:**

*2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.*

*Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.*

**Pas shpalljes se fituesit dhe formalizimit të formës ligjore të tyre duhet të dorëzohen:**

- Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është

---

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

**krijuar zyrtarisht;**

- **Prokura e posaçme.**

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1*

*b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;*

*c. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 5/1;*

*ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;*

*d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

*h. Sigurimin e ofertës referuar Neni 83 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” sipas shtojcës 7/1*

*dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri të leshuar jo më heret se 30 dite nga data e hapjes së ofertes.*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

**Është përshkruar në Kriteret e përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit.**

### **2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.3-** Xhiroja mesatare vjetore për vitet **2018, 2019 dhe 2020** duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se fondi limit dhe konkretisht **4,166,572 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë.**

**2.4-** Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2020.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se)*

**2.5-** Kopje të certifikuar të bilancit të vitit **2020** të paraqitura në autoritetin përkatës Drejtoria e Tatimeve, të konfirmuara nga ky autoritet.

### **3. Për kapacitetin teknik:**

Për të provuar përvojën e mëparshme Autoriteti Kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e dorëzimit të ofertës.

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, konkretisht se **1,666,629 (nje milion e gjashtëqind e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e njezete e nente) leke**, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e dorëzimit të ofertes.

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**5.**Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në formën e një table, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë artikujt e Listës.

Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr	Emertimi i produkteve	Emertimi kompanise prodhuese, adresa/ , web-site	Emertimi i katalogut	KOD I produktit ose nr. Faqes ne katalog	Shënimet
----	-----------------------	--	----------------------	--	----------

Emertimi i produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga AK

- Emri, Adresa/ website i kompanise prodhuese te produktit qe OE Oferton.
- Emertimi i Katalogut të prodhuesit.
- Referenca në katalogje, kodi i produktit (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr e faqes), duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut ne katalogun perkates ku autoritetit kontraktor mund të gjejë specifikimet e plota teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK.
- Në fushën “SHENIM” OE mund të shkruaj sqarime të ndryshme ne lidhje me produktet e ofruara.

**6.**Operatori ekonomik të ketë në pronësi ose me qera 1 (nje) kamion me vinç me kapacitet mbajtës nga 5 ton - 10 ton.

Per te vertetuar kete mjet duhet te paraqiten dokumentat si me poshte:

- lejen e qarkullimit.
- certifikaten e pronësisë.
- siguracionin e mjetit.
- kolaudimin.
- certifikatë transporti.
- fotografi të mjetit te paraqitur.

*Pranohet marrja me qera ose huapërdorje e mjeteve te mesiperme, me kusht qe kontrata e qeramarrjes ose huapërdorjes te jete bere para noterit, me afat vlefshmerie.*

---

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

7. Shoqëria duhet të jetë e pajisur edhe me certifikatat e mëposhtme:

- a) Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 9001-2015 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise(e vlefshme)**.
- b) Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 50001:2011–Standart për Menaxhimin e Sistemit të Energjisë (e vlefshme)**.

8. *Operatorët Ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin mostrat e produkteve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, brenda datës 17/05/2021 ora 11:00, para hapjes së vlerësimit nga KVO përkatëse. Kriteri i shërben Autoritetit Kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara, me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesën për prokurim.*

- *Ky kriter përbën kusht skualifikimi në rast se mostrat e paraqitura nuk janë sipas specifikimeve teknike.*
- *Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim.*

Bazuar në preventivin e hedhur në sistem kërkohet që të paraqiten mostra vetëm për zërat si më poshtë:

**Zëri nr. 1 – Ndricues LED 100W**

**Zëri nr.2 – Ndricues LED 50W**

**Zëri nr. 3 – Shtylla metalike 7m**

**Zëri nr.4 – Shtylle dekorative e kompletuar**

**Zëri nr.5 – Shtylle metalike per ndricim 4.5m**

**Zëri nr. 6 – Krah me dy qafore per shtylle b/a i kompletuar**

**Zëri nr. 19 – Kablo bakri 4x4**

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.



---

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

**Shtojca 9**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

**Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Karakteristikat teknike të kërkuara:

**Zëri nr. 1 – Ndricues LED 100W**

Ndricuesi duhet te jete me te pakten 155 qeliza ndricimi LED dhe te ofroje nje rendiment te ndricimit me te pakten 12000 lumen. Struktura duhet te jete e perbere prej alumini te derdhur dhe te kete shkalle mbrojtjeje te pakten IP65. Teknologjia e ndertimit te cipeve LED duhet te garantoje te pakten nje kursim prej 80% te energjise, te kete nje jetegjatesi prej te pakten 28500 ore pune dhe te ofrohet me nje garanci te pakten 5 vjecare, prodhimi i se ciles te jete ne perputhje me standardet IEC 60598 dhe EN 61547. Transmetimi i drites duhet te jete uniforme, te kete kend shperndarjeje jo me te vogel se 110° dhe me temperature ngjyre jo me pak se 6400K, rendimenti i se ciles te jete te pakten 88%. Ndricuesi duhet te kete nje shkalle mbrojtjeje mekanike te pakten te grades IK08 dhe duhet te jete operativ ne diapazonin e temperaturave nga -18°C ne +42°C. Te jete lehtesisht i montueshem ne shtyllat e ndricimit dhe te ofroje mundesi manovrimi sipas nevojave. Per ndricuesin duhet te paraqiten certifikatat e cilesise se prodhuesit, si dhe certifikatat e cilesise CE (EMS dhe LVD). Trupi ndricues duhet të jetë i çertifikuar sipas normave europiane dhe të permbajë markën CE.Të jetë i lehtë në çmontim dhe montim në

---

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

momentet që kërkohet të bëhet mirëmbajtje. Montimi të jetë i mundur në krahët e shtyllave tradicionale me diametër 48 mm dhe 60 mm.

Fuqia [W]: 100 W

Fluksi i ndricimit [lm] :  $\geq 12\ 000$  lm

Klasi i mbrojtjes [IPXX]: IP65

Tensioni i ushqimit [V]: 220 – 240 V

Frekuenca e funksionimit [Hz]: 50Hz

Teknologjia [tipi]: Led SMD 2835, 3014, 3020, 3030, 3528, 5050, 5630.

Materiali: metal

Ngjyra e trupit: gri e zënë

Temperatura e dritës [K]: 6400K

Jetëgjatësia mesatare [h]:  $\geq 28\ 500$

Klasa e efikasitetit të energjisë: A++

Temperatura e funksionimit:  $-28^{\circ}\text{C} \sim +42^{\circ}\text{C}$

Këndi i ndricimit:  $\geq 110^{\circ}$

### **Zëri nr. 2 – Ndricues LED 50W**

Ndricuesi duhet të jetë me të pakten 76 qeliza ndricimi LED dhe të ofrojë një rendiment të ndricimit me të pakten 5800 lumen. Struktura duhet të jetë e përbërë prej alumini të derdhur dhe të ketë shkallë mbrojtjeje të pakten IP65. Teknologjia e ndertimit të cipeve LED duhet të garantojë të pakten një kursim prej 80% të energjisë, të ketë një jetëgjatësi prej të pakten 28500 ore pune dhe të ofrohet me një garanci të pakten 5 vjetore, prodhimi i së cilës të jetë në përputhje me standardet IEC 60598 dhe EN 61547. Transmetimi i dritës duhet të jetë uniforme, të ketë kënd shpërndarjeje jo më të vogël se  $110^{\circ}$  dhe me temperaturë ngjyre jo më pak se 6400K, rendimenti i së cilës të jetë të pakten 88%. Ndricuesi duhet të ketë një shkallë mbrojtjeje mekanike të pakten të gradës IK08 dhe duhet të jetë operativ në diapazonin e temperaturave nga  $-18^{\circ}\text{C}$  në  $+42^{\circ}\text{C}$ . Të jetë lehtësisht i montueshem në shtyllat e ndricimit dhe të ofrojë mundësi manovrimi sipas nevojave. Për ndricuesin duhet të paraqiten certifikatat e cilësive së prodhuesit, si dhe certifikatat e cilësive CE (EMS dhe LVD). Trupi ndriçues duhet të jetë i certifikuar sipas normave europiane dhe të përmbajë markën CE. Të jetë i lehtë në çmontim dhe montim në momentet që kërkohet të bëhet mirëmbajtje. Montimi të jetë i mundur në krahët e shtyllave tradicionale me diametër 48mm dhe 60mm.

Fuqia [W]: 50 W

Fluksi i ndricimit [lm] :  $\geq 5800$  lm

Klasi i mbrojtjes [IPXX]: IP65

Tensioni i ushqimit [V]: 220 – 240 V

---

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

Frekuenca e funksionimit [Hz]: 50Hz

Teknologjia [tipi]: Led SMD 2835, 3014, 3020, 3030, 3528, 5050, 5630.

Materiali: metal

Ngjyra e trupit: gri e zënë

Temperatura e dritës [K]: 6400K

Jetëgjatësia mesatare [h]: >28 500

Klasa e efikasitetit të energjisë: A++

Temperatura e funksionimit: -18°C ~ +42°C

Këndi i ndricimit:  $\geq 110^\circ$

### **Zëri nr. 3 – Shtylla metalike 7m**

Gjatesia e shtylles duhet të jete 6.5 - 7 m. Shtylla duhet të jete e galvanizuar në të nxehtë. Trashësia e materialit nuk duhet të jete më e vogël se 3.8 mm. Diametri i bazës së poshtme nuk duhet të jete më i madh se 157 mm ndërsa diametri i bazës së sipërme nuk duhet të jete më i madh se 63mm. Peshë e shtylles duhet të jete midis 78-84kg. Materiali i shtylles duhet të jete çelik i tipit S235 JRH sipas standardit EN 10219 ose ekuivalent. Rezistenca në tërheqje duhet të jete ndërmjet 340 – 510 N/mm<sup>2</sup> dhe zgjatja që mund të peshojë materiali të jete jo më e madhe se 22%. Shtylla duhet të jete e lyster me bojë hidrostatike me pluhur sipas kodit RAL 9007. Gjithashtu, shtylla duhet të jete e pajisur me një hapësirë të prerë me permasa jo më të vogla se 183x43 mm. Kjo hapësirë nevojitet për lidhjen e ndricuesit me rrjetin elektrik. Kapaku duhet të jete i pajisur me çelës, duhet të ketë perberje alumini dhe një peshe jo më të madhe se 300gr. Kapaku duhet të ketë një shkallë mbrojtjeje IP 54 në përputhje me standardin CEI 60529 dhe një rezistenca ndaj goditjes IK 08 në përputhje me standardin EN 50102. Për të vertetur cilësinë dhe përputhshmerinë e mallit operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë cilësie të prodhuesit dhe certifikatën e konformitetit.

### **Zëri nr. 4 – Shtyllë dekorative e kompletuar**

Gjatesia e shtylles duhet të jete jo më e madhe se 2.2m. Diametri i shtylles duhet të jete jo më i vogël se 55mm. Peshë e shtylles së bashku me krahët duhet të jete jo më e madhe se 14kg. Materiali i shtylles duhet të jete çelik i tipit S235 JRH sipas standardit EN 10219 ose ekuivalent. Rezistenca në tërheqje duhet të jete ndërmjet 340 – 510 N/mm<sup>2</sup> dhe zgjatja që mund të peshojë materiali të jete jo më e madhe se 22%. Shtylla duhet të jete e lyster me bojë hidrostatike me pluhur sipas kodit RAL 9007. Krahët dekorativë duhet të kenë një largësi nga qendra jo më të

---

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

madhe se 260mm, nje lartesi jo me te vogel se 240mm dhe nje diameter 58 – 72mm. Gjithashtu, shtylla duhet te jete e pajisur me nje hapësire te prere me permasa jo me te vogla se 130x35 mm. Kjo hapësire nevojitet per lidhjen e ndricuesit me rrjetin elektrik. Kapaku duhet te jete i pajisur me celes, duhet te kete perberje alumini dhe nje peshe jo me te madhe se 190gr. Kapaku duhet te kete nje shkalle mbrojtjeje IP 54 ne perputhje me standardin CEI 60529 dhe nje rezistence ndaj goditjes IK 08 ne perputhje me standardin EN 50102. Per te vertetuar cilesine dhe perputhshmerine e mallit operatori ekonomik duhet te paraqese certifikate cilesie te prodhuesit dhe certifikaten e konformitetit.



(shtylle dekorative)

**Zëri nr. 5 – Shtylle metalike per ndricim 4.5m**

Gjatesia e shtylles duhet e jete 4.2-4.7 m. Shtylla duhet te jete e galvanizuar ne te nxehte. Trashesia e materialit nuk duhet te jete me e vogel se 2.75mm. Diametri i bazes se poshtme nuk duhet te jete me i madh se 160 mm ndersa diametri i bazes se sipërme nuk duhet te jete me i madh se 62mm. Pesha e shtylles duhet te jete midis 26-32kg. Materiali i shtylles duhet te jete celik i tipit S235 JR sipas standardit EN 10025 ose ekuivalent. Rezistenca ne terheqje duhet te jete ndermjet 340 – 510 N/mm<sup>2</sup> dhe zgjatja qe mund te pesoje materiali te jete jo me e madhe se 22%. Shtylla duhet te jete e lyer me boje hidrostatike me pluhur sipas kodit RAL 9007. Gjithashtu, shtylla duhet te jete e pajisur me nje hapësire te prere me permasa jo me te vogla se 130x35 mm. Kjo hapësire nevojitet per lidhjen e ndricuesit me rrjetin elektrik. Kapaku duhet te jete i pajisur me celes, duhet te kete perberje alumini dhe nje peshe jo me te madhe se 190gr. Kapaku duhet te kete nje shkalle mbrojtjeje IP 54 ne perputhje me standardin CEI 60529 dhe nje

---

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

rezistence ndaj goditjes IK 08 ne perputhje me standardin EN 50102. Per te vertetuar cilesine dhe perputhshmerine e mallit operatori ekonomik duhet te paraqese certifikate cilesie te prodhuesit dhe certifikaten e konformitetit.

**Zëri nr. 6 – Krah me dy qafore per shtylle b/a**

Krahu duhet te jete i perbere prej celiku te galvanizuar ne te nxehte sipas standardeve Europiane. Gjatesia e krahut nuk duhet te jete me e madhe se 1.7 m dhe lartersia e tij nuk duhet te jete me e madhe se 1.65 m. Pesha e krahut se bashku me qaforet mbajtese duhet te jete me e madhe se 16 kg. Qaforet lidhese duhet te kene nje mekanizem shtrengimi me vidhosje, diametri i krahut nuk duhet te jete me i vogel se 57 mm. Per te vertetuar cilesine dhe perputhshmerine e mallit operatori ekonomik duhet te paraqese certifikate cilesie te prodhuesit dhe certifikaten e konformitetit.



(krah per shtylle b/a)

**Zëri nr. 7 - Krah 1500mm**

Krahu duhet te kete permasa 1.5x1.5m. Diametri i krahut duhet te jete midis 57 – 64mm. Rrezja e krahut nuk duhet te jete me e vogel se 0.8 m. Pesha e krahut duhet te jete jo me e madhe se 13 kg. Krahet duhet te jene te lyer me boje hidrostatike me pluhur sipas kerkesave te autoritetit kontraktor. Per te vertetuar cilesine dhe perputhshmerine e mallit operatori ekonomik duhet te paraqese certifikate cilesie te prodhuesit dhe certifikaten e konformitetit.

**Zëri nr. 11 – Automat 1P 10A**

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

Automati duhet të jetë i prodhuar sipas standardeve IEC 60947 dhe EN 60898 ose ekuivalent. Të jetë i tipit termo-magnetik dhe operativ në tension 240 V. Fuqia në çkyçje e automatit duhet të jetë të paktën 8.8 kA, frekuenca 50-60Hz dhe kurba e nderhyrjes C . Të ofroje qëndrueshmeri elektrike të paktën për 9000 cikle operative, të kësaj klase mbrojtjeje të paktën IP20 dhe rezistent deri në temperaturë +68°C. Për automatin duhet të paraqiten certifikatat e cilësive të prodhuesit, si dhe certifikatat e cilësive CE.

**Zëri nr. 19 – Kablo bakri 4x4**

Kabli duhet të jetë i prodhuar në përputhje me standardet evropiane EN 6050575, IEC 60502 ose ekuivalente. Kabli duhet të ketë veti të shkelqyera si elektrike, ashtu dhe mekanike dhe të jetë i përshtatshëm për operime deri në 1kV. Duhet të ketë izolim cilësor me material PVC dhe veshje të dyfishtë me gome. Përcjellesi i kabllit të ketë diametër jo më të vogël se 13.3 mm dhe me peshë specifike jo më të vogël se 380 g/m. Përcjellesi të ketë rezistencë të paktën 4.28 ohm/km. Të jetë rezistent ndaj zjarrit dhe në përputhje me standardin EN 60332. Kabli duhet të jetë i përshtatshëm për instalime të jashtme dhe të përmbajë siglen FG7(O)R ose atë të normativës së re FG16OR16. Të paraqiten certifikatat CE të produktit dhe ato të cilësive të prodhuesit për të vertetuar përputhshmerinë me standardet e kerkuara.

**Zëri nr. 20 – Kablo bakri 4x6**

Kabli duhet të jetë i prodhuar në përputhje me standardet evropiane EN 6050575, IEC 60502 ose ekuivalente. Kabli duhet të ketë veti të shkelqyera si elektrike, ashtu dhe mekanike dhe të jetë i përshtatshëm për operime deri në 1kV. Duhet të ketë izolim cilësor me material PVC dhe veshje gome. Përcjellesi i kabllit të ketë diametër jo më të vogël se 14.8 mm dhe me peshë specifike jo më të vogël se 470 g/m. Përcjellesi të ketë rezistencë të paktën 2.98 ohm/km. Të jetë rezistent ndaj zjarrit dhe në përputhje me standardin EN 60332. Fuqia minimale e rezistencës në djegie të mos jetë më e ulët se 39.7A. Kabli duhet të jetë i përshtatshëm për instalime të jashtme dhe të përmbajë siglen FG7(O)R ose atë të normativës së re FG16OR16. Të paraqiten certifikatat CE të produktit dhe ato të cilësive të prodhuesit për të vertetuar përputhshmerinë me standardet e kerkuara.

**Zëri nr. 21 – Kablo bakri 3x4**

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

Kabli duhet të jetë i prodhuar në përputhje me standardet europiane EN 6050575, IEC 60502 ose ekuivalente. Kabli duhet të ketë veti të shkelqyera si elektrike, ashtu dhe mekanike dhe të jetë i pershtatshëm për operime deri në 1kV. Duhet të ketë izolim cilësor me material PVC dhe veshje të dyfishtë. Përcjellesi i kabllit të ketë diametër jo më të vogël se 12.6mm dhe me peshë specifike jo më të vogël se 317 g/m. Përcjellesi të ketë rezistencë të pakten 4.47 ohm/km. Të jetë rezistent ndaj zjarrit dhe në përputhje me standardin EN 60332. Fuqia minimale e rezistencës në djegie të mos jetë më e ulët se 31.8A. Kabli duhet të jetë i pershtatshëm për instalime të jashtme dhe të përmbajë siglen FG7(O)R ose ato të normativës së re FG16OR16. Të paraqiten certifikatat CE të produktit dhe ato të cilësive së prodhuesit për të vertetuar përputhshmerinë me standardet e kërkuara.

**Zëri nr. 22 – Kablo bakri 3x2.5**

Kabli duhet të jetë i prodhuar në përputhje me standardet europiane EN 6050575, IEC 60502 ose ekuivalente. Kabli duhet të ketë veti të shkelqyera si elektrike, ashtu dhe mekanike dhe të jetë i pershtatshëm për operime deri në 1kV. Duhet të ketë izolim cilësor me material PVC dhe veshje të dyfishtë. Përcjellesi i kabllit të ketë diametër jo më të vogël se 10.7 mm dhe me peshë specifike jo më të vogël se 210 g/m. Përcjellesi të ketë rezistencë të pakten 7.28 ohm/km. Të jetë rezistent ndaj zjarrit dhe në përputhje me standardin EN 60332. Fuqia minimale e rezistencës në djegie të mos jetë më e ulët se 22.8A. Të paraqiten certifikatat CE të produktit dhe ato të cilësive së prodhuesit për të vertetuar përputhshmerinë me standardet e kërkuara.

**Zëri nr. 23 – Kablo bakri 3x1.5**

Kabli duhet të jetë i prodhuar në përputhje me standardet europiane EN 6050575, IEC 60502 ose ekuivalente. Kabli duhet të ketë veti të shkelqyera si elektrike, ashtu dhe mekanike dhe të jetë i pershtatshëm për operime deri në 1kV. Duhet të ketë izolim cilësor me material PVC dhe veshje të dyfishtë PVC. Përcjellesi i kabllit të ketë diametër jo më të vogël se 10.8 mm dhe me peshë specifike jo më të vogël se 176 g/m. Përcjellesi të ketë rezistencë të pakten 11.85 ohm/km. Të jetë rezistent ndaj zjarrit dhe në përputhje me standardin EN 60332. Fuqia minimale e rezistencës në djegie të mos jetë më e ulët se 17.6A. Të paraqiten certifikatat CE të produktit dhe ato të cilësive së prodhuesit për të vertetuar përputhshmerinë me standardet e kërkuara.

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

**Të gjitha materialet e tjera duhet të jenë të certifikuara dhe të testuara, gjithashtu duhet të mbajnë logon CE dhe të jenë të pershtatshme me normativat elektrike të Republikës së Shqipërisë.**

**KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.



---

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**


---

**Shtojca 10**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT**

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Nr/analize	Emertimi i bazes materiale	Njesi	Sasi	Cmim	Vlefta
1	3.An/55	Ndricues LED 94-100W	cope	63		
2	An	Ndricues LED 50W	cope	48		
3	3.An/53	Shtylla metalike per ndriçim, H=7m, d=160mm	cope	66		
4	An	Shtylle dekorative e kompletuar	cope	5		
5	An	Shtylla metalike per ndriçim, H= 4.5-7m, d=160mm	cope	15		
6	3an/ksh	Krah KRH - me dy qafore per shtylle b/a	cope	22		
7	3an/ksh	Krah KRH - MSI 1500/1500/10	cope	74		
8	An	Kuti shperndarese jasht murit IP56 150x110x70mm	cope	85		
9	An	Tel xingato 2.5mm <sup>2</sup>	kg	89		
10	An	Fasheta plastike 3.6x300mm zeze, pako 100cp	cope	34		
11	An	Automat 10A, C, 230V, 6kA	cope	103		
12	An	Profil metalike i xinguar gjysem cilindrik per mbrojtjen e kabllit	ml	30		
13	An	Upa plastike M10+ bulon	cope	90		
14	An	Fasheta metalike ø 75mm	cope	30		
15	4.149/7	Percjelles tokezimi CU-16mm <sup>2</sup>	ml	210		
16	1.31p	Prodhim betoni C - 25/30 (me zall)	m <sup>3</sup>	20		
17	3An et	Elektroda tokezimi+morsete. 50x50x5mm L=1.5 m e galvanizuar	cope	117		
18	2.490/g	F.V Kuader komandimi komplet santeri+fotoelement	cope	6		
19	An	Kabell 4x4 FG7OR	ml	2650		
20	An	Kabell 4x6 FG7OR	ml	800		
21	An	Kabell 3x4mm <sup>3</sup> FG16OR16	ml	570		
22	An	Kabell 3x2.5 FG7OR	ml	800		
23	3.an/55	Kabell special 3x1.5	ml	1040		
24	An	Klema 10mm <sup>2</sup>	cope	260		

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

25	An	Klema 6mm2	cope	1000		
26	An	Klema 4mm2	cope	800		
27	An	Klema 2.5mm2	cope	200		
28	An	Nastro izolante e zeze 3M pvc	cope	190		
29	An	Nastro izolante gome	cope	22		
30	An	Tube plastike fi 200mm e brinjezuar	ml	102		
31	An	Puset PVC elektrike 20x20	cope	32		
32	3.an/55	Siguresa 4A	cope	14		
33	An	Tube cavidoto dopio isolim 40mm2	ml	910		
34	An	Shtrese rere lumi	m3	3		
		<b>Shuma</b>				
		<b>TVSH 20%</b>				
		<b>Totali</b>				

Afatet e lëvrimet: Sipas kërkeses se AK deri me 20 ditë kalendarike.

---

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

**Shtojca11**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>	_____	_____
<b>02</b>	_____	_____
<b>03</b>	_____	_____
<b>...</b>	_____	_____

---

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

**Shtojca12**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>3</sup>**

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< **Emri** >

---

<sup>3</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

---

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

**Shtojca 13**

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_  
numri i NIPT-it \_\_\_\_\_  
Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_  
numri i NIPT-it \_\_\_\_\_  
Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_  
numri i NIPT-it \_\_\_\_\_  
2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_  
numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

**Shtojca 14**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

---

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj.\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**



---

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

**Shtojca 15**

**KUSHTET E PËRGJITHSHME  
Mallrat –Kërkesë për propozim**

**Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

**Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi,

---

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

**Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

**Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.

---

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

**Neni 6: Pronësia Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikave, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t’i përdorë për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor ngapërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t’i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

**Neni 7: Origjina e Mallrave**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

---

**“Blerje bazë materiale për ndriçime rrugore”**

- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

**Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet**

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojine specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

**Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike**

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
